

RAPORT MONITORIMI

**Mbi elementët e ekstremizmit të dhunshëm
që qarkullojnë në platformat online në Shqipëri**

Janar 2020

Financuar nga



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Autorët:

Edlira Gjollëshi

Eda Buci

Konsulent: Erjon Tase

Ky studim u hartua falë bashkëpunimit me disa prej insitucioneve të sigurisë në vend. Një mirënjohje e veçantë u drejtohet të gjithë ekspertëve vendas që kanë vendosur bazat për metodologjinë e monitorimit të mesazheve ekstremiste online.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Botimi është pjesë e projektit “Rritja e rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm në ekosistemin kibernetik shqiptar”, i mbështetur financiarisht nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun e Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit /eve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
2. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT	5
3. ANALIZA E MONITORIMIT	9
3.1 MEDIAT SOCIALE	9
3.1.1 RRJETI SOCIAL FACEBOOK	9
3.1.2 YOUTUBE	10
3.1.3 TWITTER, TELEGRAM DHE INSTAGRAM	11
3.2 FAQET WEB	13
3.3 LOJËRAT ONLINE	13
3.4 GRUPMOSHAT DHE GJINIA E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË KOMUNIKIMIN EKSTREMIST ONLINE	14
4. KONKLUZIONE	15
5. REKOMANDIME	16
SHTOJCA 1, MOTORËT E KËRKIMIT	19
SHTOJCA 2, DISA REFERENCA TE GJETURA NGA FAQET WEB	20
SHTOJCA 3, DISA REFERENCA TE GJETURA NGA FACEBOOK	21
SHTOJCA 4, DISA LINKE TE GJETURA NGA YOUTUBE	21
SHTOJCA 5, DISA LINKE TE GJETURA NGA TWITTER, INSTAGRAM, TELEGRAM	21
LINKET E GJETURA NGA TWITTER	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
LINKET E GJETURA NGA TELEGRAM	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
SHTOJCA 6, FJALËT KYÇE PËR MONITORIM	21
FJALËT KYÇE PËR MONITORIM	21
ME RISK TË LARTË	21

1. HYRJE

Ekstremizmi i dhunshëm dhe forcat që nxisin radikalizimin janë ndër sfidat më të vështira të ditëve tona. Shqipëria është angazhuar për të përmbushur qëllimet e sigurisë kombëtare, për të pasur stabilitet dhe qëndrueshmëri si dhe për të parandaluar dhe luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë qëllim, është zhvilluar dhe konsoliduar korniza ligjore dhe institucionale në përputhje (Acquis) me zhvillimet ndërkombëtare anti-terrorizëm, duke forcuar mekanizmat e brendshëm institucionalë dhe duke investuar në partneritete dhe iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.

Me mposhtjen e të ashtëquajturit Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS), i cili vepronte hapur, me forca të rregullta dhe me sulme të orkestruara nga një “qeveri shtet”, tashmë grupet ekstremiste që i kanë mbijetuar arrestimit dhe ndjekjes nga forcat e ligjit, mund të vazhdojnë të mbajnë komunikim dhe propagandojnë për ndjekësit e tyre nëpërmjet komunikimit online. ISIS ka dëshmuar tashmë se zotëron ekspertizë në komunikimin dhe teknologjinë elektronike falë përdorimit të metodave të rekrutimit online të luftëtarëve të huaj nga shumë vende të Evropës. Kjo eksperiencë në propagandimin nëpërmjet mediave sociale dhe videomesazheve mund të shfrytëzohet përsëri për të mbajtur gjallë lidhjet me personat e radikalizuar, por edhe për të rekrutuar anëtarë të rinj që mund të organizojnë veprime të dhunshme dhe sulme të armatosura në vende të ndryshme perëndimore.

Shqiptarët, ishin një nga grupet e targetuara nga propaganda online e ISIS në vitet 2015-2017, e cila rezultoi efektive për radikalizimin dhe rekrutimin e mbi 500 luftëtarëve dhe familjeve të tyre nga trojet ku jetojnë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë. Një studim i mbështetur nga Akademia e Studimeve Politike në vitin 2015¹, zbuloi një strategji të sofistikuar komunikimi online publik të ISIS në gjuhën shqipe, me synim rekrutimin e tyre si luftëtarë në zonat e konfliktit. Gjuha shqipe është gjithashtu një nga pesë gjuhët e përdorura për komunikimin në atë që cilësohet faqja zyrtare online e ISIS (<https://hilafeti.wordpress.com>), duke dëshmuar edhe njëherë rrezikshmërinë që mund të përbëjë ky grup terrorist për radikalizimin e shqiptarëve edhe në këtë situatë të re.

Shqipëria ka përfituar nga axhenda dixhitale që Komisioni Europian zbaton në Ballkan në ngritjen e rrjeteve kombëtare brezgjere, si infrastrukturë bazë për të gjithë operatorët e internetit. Përdorimi në shkallë të gjerë i internetit dhe teknologjive moderne të komunikimit nga qytetarët shqiptarë vlerësohet si një domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe afrimin gradualisht me nivelet e vendeve të Bashkimit Europian.

Politikat aktuale në Shqipëri nxisin zgjerimin e shërbimit të internetit për të mbuluar shumë zona të vendit si dhe liberalizimin e tregut të telekomunikacionit duke nxitur konkurrencën e operatorëve të ndryshëm. Këta të fundit janë një arsye për rritjen e përdoruesve të internetit falë adoptimit të teknologjisë, ngritjes së shërbimit ëireless, paketave agresive promovuese

¹ Strategjia e komunikimit online publik të ISIS në Shqipëri - 2015
http://www.asp.al/pdf/Strategjia_e_komunikimit_te_IS_-_Koncept_paper_13_Nentor.pdf

me shërbimet e integruara (telefoni, internet, TV) dhe nxitjen e interesit në përmbajtje në rrjet të tilla si video, trasmetime direkte etj.

Rritja e konsumatorëve të internetit në vendin tonë lidhet jo vetëm me trendin global të përdorimit të teknologjisë, por dhe liberalizimin e tregut dhe një presion pozitiv që kanë ushtruar instancat qeveritare për përdorimin e internetit veçanërisht për biznesin. Prokurimet me mjete elektronike, shërbimet online të platformës E-Albania, si dhe lehtësira të tjera për të evituar rradhët në sportele dhe korrupsionin, kanë patur presion pozitiv për rritjen e kërkesës për shërbimin e internetit në vend.

Sipas statistikave të INSTAT², 82.2 përqind e familjeve shqiptare patën qasje në internet në vitin 2019, duke shënuar një nivel penetrimi në internet më të lartë se mesatarja botërore (e llogaritur në 58.8 %). Duke patur një popullsi të re në moshë, vendi ynë përdor intensivisht telefonat celularë smartphone, të cilët ofrojnë kudo dhe me kosto të ulët shërbimin e internetit mbi bazën e një infrastrukture solide 4G.

Të dhënat e INSTAT zbulojnë gjithashtu se përdorimi i internetit “çdo ditë/pothuajse çdo ditë”, ka regjistruar përqindjet më të larta ndër vite për të gjitha grupmoshat, ku vendin kryesor e zënë grupmoshat 16 - 24 vjeç me rreth 93,1 % si dhe grupmoshat 25 - 34 vjeç, 92.4%. Përdorimi i internetit sipas gjinive, tregon se meshkujt janë përdorues më të shumtë, me 71,2 % të përdoruesve, në krahasim me 66 % përdoruese femra. Nga ana tjetër, aktivitetet kryesore që kryhen nëpërmjet internetit janë kërkimi i informacionit (për 50,2 % të përdoruesve të internetit), shkëmbimi i informacionit, e-mail (32,5 %) Youtube, filma në internet (live ose të ruajtura online 38,2 %).

Së bashku me këtë zhvillim pozitiv të përhapjes së internetit, është shtuar mundësia e ekspozimit të shoqërisë dhe sidomos të rinjve, si përdoruesve më të shumtë, ndaj rreziqeve të ndryshme që qarkullojnë në hapësirën online. Në këtë realitet të ri virtual të “world wide web”, grupet radikale dhe ekstremiste kanë siguruar një mënyrë efikase për të përhapur ideologjitë e tyre si dhe bashkëpunuar dhe bindur ndjekës pa asnjë limit gjeografik apo kohor. Interneti është një lehtësues i spikatur për bashkëveprimin ndërnjerëzor. Një lëvizje radikale mund të ekzistojë tek një grup virtual në të cilin mund të bëjnë pjesë njerëz që nuk janë takuar asnjëherë në jetën reale, por që janë lidhur përmes qëndrimeve dhe ideologjive të përbashkëta.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian, për Shqipërinë për vitin 2019³: *“Përhapja e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes internetit në Shqipëri po rritet. Autoritetet duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre të monitorimit dhe reagimit në internet, dhe të përmirësojnë përpjekjet për të fuqizuar shoqërinë civile për të pasur zhvillime pozitive në përdorimin e internetit. Qeveria gjithashtu duhet të shtojë përpjekjet për të luftuar ndikimet e jashtme, përfshirë prurjet financiare që mund të çojnë në radikalizim të mëtejshëm”*.

² INSTAT, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët 2018-2019

<http://www.instat.gov.al/media/6435/anketa-mbi-p%C3%ABrdorimin-e-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt-2018-2019.pdf>

³ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

Një ndër grupet më vulnerabël ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe fenomeneve të tjera negative që shoqërojnë komunikimin në internet, janë fëmijët dhe të rinjtë, të cilët janë akoma kërkues të identitetit të tyre. Një studim⁴ i realizuar nga UNICEF në Shqipëri tregoi se më shumë se 20% e fëmijëve të anketuar pranojnë të gjitha kërkesat për shoqëri në rrjete sociale, 25% e tyre kanë bashkëvepruar online me dikë që nuk e njohin në jetën reale, 16% e tyre kanë takuar personalisht dikë që e kanë njohur në internet dhe prindërit kanë njohuri vetëm për 9% të eksperiencave të fëmijëve në internet.

Përballë këtyre zhvillimeve, është e nevojshme që institucionet ligjzbatuese të forcojnë mekanizmat e monitorimit dhe bashkëpunimit me industrinë e teknologjisë dhe telekomunikacionit për të ofruar një mjedis më të sigurt online.

Ky raport ka për qëllim të monitorojë raste të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes internetit në Shqipëri, të trajtojë këtë fenomen, të vlerësojë burimet ligjore, institucionale dhe njerëzore të disponueshme, të identifikojë boshllëqet për të marrë masat e nevojshme për të parandaluar fenomene të tilla, si dhe për të ofruar një mjedis elektronik të sigurt.

Më konkretisht, procesi i monitorimit ka si objektivi:

1. Kërkimi i përmbajtjeve me prirje ekstremiste në Shqipëri në platformat online (faqe interneti, bloge, rrjete sociale etj);
2. Specifikimi dhe analiza e individëve dhe organizatave me prirje ekstremiste;
3. Specifikimi i platformave online të përdorura, rrjeteve sociale, website-ve për të shpërndarë përmbajtje ekstremiste;
4. Ofrimi i statistikave të vlefshme për ndërtimin e politikave përkatëse.

2. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT

Procesi i monitorimit u mbështet në metodologjitë dhe publikimet e punëve kërkimore, si dhe analizave në projekte të ngjashme të iniciuara e drejtura nga Komisioni Evropian⁵. Në këtë proces është përdorur metodologjia e analizës së përmbajtjes, nëpërmjet kërkimit me fjalë kyçe, për të kuptuar narrativën, grupin e shenjëstruar në Shqipëri dhe platformat elektronike të përdorura. Gjithashtu, bazuar mbi përkufizimin Mc Farlane (2010), u përcaktua se çfarë mund të përkufizohet si ekstremizëm i dhunshëm online. Sipas studiuesit: “ekstremizëm i

⁴ Studimi ‘Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e Internetit në Shqipëri’.

<https://www.unicef.org/albania/viral-summit-better-Internet-children-and-adolescents-albania>

⁵ https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers_en

dhunshëm online përkufizohet përdorimi i sistemeve të komunikimit online si mjet për shtyrjen dhe/ose influencimin e individëve dhe grupeve për të zhvilluar, adaptuar dhe/ose avancuar sisteme besimi që shtrihen jashtë normave të pranuar nga shoqëria, duke rezultuar në mbështetjen e kërcënimeve dhe/ose akte fizike të dhunës për të përhapur këtë sistem besimi”⁶.

Metodologjia e përdorur konsistonte në ndërtimin e një listë të fjalëve kyçe që mund të çonin përdoruesit drejt përmbajtjeve ekstremiste, kur ato futen në motor kërkimi. Këto fjalë kyçe u kategorizuan bazuar në llojin e tyre ideologjik dhe rrezikun e mundshëm që lidhen me to. Gjithashtu elementet e kërkimit u bazuan edhe në fjalët kyçe të përdorura në raportet e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), përsa i përket përhapjes së propagandës dhe thirrjeve për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në Shqipëri.

Për secilën nga këto fjalë kyçe, u konstatua numri mesatar i personave që propagandojnë ideologjitë e tyre ekstremiste, përfshirë këtu edhe ekstremizmin etnik, politik etj. U evidentuan personat e interesuar në to, gjinitë në përqindje të përfshira, mosha mesatare, lloji i arsimimit etj.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave është bërë nga një grup prej gjashtë kërkuesish me eksperiencë në çështjet e monitorimit të ekstremizmit të dhunshëm si dhe komunikimit online, gjatë dy muajve në periudhën **Nëntor - Dhjetor 2019**.

Monitoruesit përpiluan një listë të faqeve të internetit të njohura ose që dyshohet se kishin përmbajtje ekstremiste, u analizuan këto faqe së bashku me të dhënat lidhëse që mund të ridrejtonin në faqe të tjera me përmbajtje të dëmshme.

*Kategorizimi i Fjalëve Kyçe*⁷

Për të identifikuar nivelin e rrezikut të lidhur me secilën fjalë në përmbajtjen ku bëjnë pjesë, fjalët kyçe u ndanë në kategoritë:

- **Kategoria 1:** Fjalë ekstreme, të dhunshme
- **Kategoria 2:** Fjalë kyçe të përgjithshme

Kategorizimi i fjalëve kyçe të tilla si 'kokëzimi' ose 'vrasja e apostateve' janë në thelb me përmbajtje të dhunshme, ndërsa të tjerat, siç janë 'kryqëzatat' ose 'kalifati' janë më të përgjithshme në natyrën e tyre, për këtë arsye përmbajtja e tyre duhej të analizohet me kujdes, me qëllim që të mos ndikonte të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të mendimit.⁸

⁶ McFarlane, B., Online Violent Radicalisation (OVer): Challenges Facing Law Enforcement Agencies and Policy Stakeholders, Monash University, 2010

⁷ Shtojca 6, fjalët kyçe për monitorim

⁸ EU Human Rights Guidelines on Freedom of Expression Online and Offline
<https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/142549.pdf>

Fjalë kyçe me risk të lartë	Fjalë kyçe të përgjithshme
Jelek vetëvrasësi	Dëshmor
Vrasja e apostujve	Xhihad

Tabela nr.1: Kategorizimi i fjalëve kyçe

Midis kategorive ishte e pashmangshme mbivendosja, megjithatë përcaktimi pasqyroi vetëm natyrën e fjalës dhe jo lidhjet e saj me ndonjë grup të veçantë. Kjo do të thotë që koncepti i "khilafah" është më i lidhur me ISIS-in, por vetë fjala nuk ka domethënie të dhunshme apo ekstreme. Si rezultat, ajo u kategorizua në listën e fjalëve politike islamike.

Frekuencat e Fjalëve Kyçe

Të dhënat për përdorimin e fjalëve kyçe, u siguruan duke iu drejtuar motorëve të kërkimit⁹, ku nëpërmjet të dhënave historike të Google, u filtruan rezultatet specifike me përmbajtje radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Megenëse monitorimi nuk kishte qasje në të dhënat gjithëpërfshirëse të Google, këto frekuenca mesatare, mund të përdoren si një udhëzues i dobishëm për popullaritetin e fjalëve të përdorura në internet dhe tendencat gjeografike, por nuk japin shifra të sakta ose përfundimtare.

Frekuencat lokale u mblodhën si për fjalët kyçe në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën arabe. Të dhënat për frekuencat e fjalëve arabe nuk korrespondojnë ekskluzivisht me zonën gjeografike arabe, por arsytimi për të zgjedhur fjalët kyçe në gjuhën arabe, vjen nga fakti se, është gjuha e përdorur nga grupime të ndryshme ekstremiste.

Më pas u identifikuan personat, të cilët ishin aktivë në faqet e internetit, mediat sociale, youtube, ku gjendeshin fjalët kyçe, si dhe u nxorën statistika mbi gjininë, moshën, vendndodhjen e tyre.

Kategorizimi i përmbajtjes

Kategorizimi i përmbajtjes u krijua për të pasur një pasqyrë më të detajuar të llojit të përmbajtjes ku gjenden fjalët kyçe të analizuara. Përcaktimet të përmbajtjes së gjetur në një website nuk pasqyrojnë gjykimin për një faqe të tërë, por vetëm të përmbajtjes ku ndodhej fjala kyçe.

⁹ Shtojca 1, Motorët e kërkimit

Kategoritë	Ekstreme	Neutral	Informative	Antiislamike
1	Të dhunshme			
2	Jo të dhunshme			
3	Politike Islamike			
4		Lajme, Analizime, Ideologji fetare		
5			Shoqëria Civile	
6			Qeveritare	
7			Grupe Fetare	
8				Antiislamike

Tabela nr.2: Kategorizimi i përmbajtjeve ku gjenden fjalët kyçe

Grupimi mbi përmbajtjen ekstreme u nda në tre nën kategori; i dhunshëm, jo i dhunshëm dhe përmbajtje politike radikale të grupeve terroriste. Përmbajtjet u kategorizuan si të dhunshme nëse ato përmbanin imazhe grafike të dhunës ose nxitje të dhunës.

Përmbajtjet që u vlerësuan të jenë ekstreme, por jo të dhunshme ishin ato që shprehnin pikëpamje antisemite, homofobike, raciste ose sektare, por pa nxitur dhunën. Kategoria përmbajtje politike radikale përfshinte përmbajtje, të cilat shprehnin një prirje specifike ndaj një grupi të veçantë islamik. Kjo kategori në mënyrë të qartë iu referua grupeve të njohura politike, që janë duke kërkuar në mënyrë aktive për të fituar pushtet politik.

Grupimi mbi përmbajtjet neutrale përfshin webfaqet kryesore të mediave, faqet e internetit, të cilat përhapin ideologji fetare.

Grupimi mbi përmbajtjet informative (kundër-narrative) ndahet në tre nënkategori: grupet e shoqërisë civile, grupet qeveritare dhe grupet fetare. Për grupet fetare, kjo përfshin organizata të njohura fetare, si dhe individë me prirje islamike, të cilët përhapin ideologji mbi besimin e tyre.

Grupimi mbi përmbajtjen antiislamike përfshin disa fjalë kyçe ku ekziston prania e vazhdueshme e informacionit me përmbajtje ekstremiste anti-muslimane.

Fillimisht monitorimi u tentua nëpërmjet disa tools/ aplikacioneve open source, por të dhënat e gjeneruara nuk ishin të grupuara dhe orientuara sipas specifikës së kërkimit. Për këtë arsye, u përdor kërkimi manual sipas motorëve të ndryshëm të kërkimit (shiko *shtojçën 1*), për të tërhequr elektronikisht nga baza e të dhënave të Google, informacion mbi faqet në internet me përmbajtje të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.

3. ANALIZA E MONITORIMIT

Kërkimi empirik është përqendruar në monitorimin e platformave online (faqe interneti, bloge, rrjete sociale etj) më të përdorura në Shqipëri, si Facebook, Twitter, YouTube, Instagram, por dhe Lojëra Online, për raste të përhapjes së propagandave apo influencimit të pikëpamjeve të caktuara, që mund të çojnë në radikalizëm apo ekstremizëm të dhunshëm. Në fazën kur dikush ka ndjekur një hashtag apo i është bashkuar një grupi në mediat sociale, ka të ngjarë që tashmë ka treguar hapje ndaj asaj ideologjie. Nga hulumtimi u konstatua se, në Shqipëri ekzistojnë faqe të shumta web-i si dhe llogari në rrjete sociale, të cilat mund të përdoren për të përhapur ideologji ekstremiste.

3.1 MEDIAT SOCIALE

Mediat sociale luajnë rol kyç në propagandën që përhapet rreth radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, përfshirë këtu rrjete sociale si:

3.1.1 RRJETI SOCIAL FACEBOOK¹⁰

Statistikat tregojnë se në Shqipëri shkalla e penetrimit të Facebook në Janar të vitit 2019¹¹ arrinte në rreth 47.6 % të popullsisë dhe numri i përdoruesve të Facebook, arrinte në rreth 1.4 milionë, duke qënë media sociale me shtrirje më të gjerë në vend.

Gjatë kërkimit të fjalëve kyçe u vu re se rrjeti social Facebook përdoret më së shumti nga përdoruesit që përhapin propagandë ekstremiste në gjuhën shqipe. Pavarësisht se u konstatuan disa përdorues me llogari fiktive dhe disa organizata me profile të dyshimta fetare, u mundësua një analizë e detajuar e përdoruesve dhe përmbajtjes që ata ndajnë me të tjerët.

Në Facebook u monitoruan gjithsej 42 adresa përdoruesish, nga ku:

- 28 adresa përhapin propagandë fetare;
- 4 adresa përdoruesish përhapin ideologji ekstremiste politike;
- 4 shprehin ideologji rreth luftës etnike;
- 2 rreth implikimeve terroriste në Shqipëri;
- 4 përdorues që përhapin ideologjitë e tyre rreth diskriminimit fetar.

¹⁰ Sipas Shtojcës 3, referencat e gjetura nga Facebook.

¹¹ <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm>



Fig1 : Nr. llogarive në Facebook që përhapin propaganda sipas kategorive në grafik

Për secilën nga kategoritë e përmbajtjes u konstatua si më poshtë:

- **Propaganda fetare**
Pëlqimet-318,945; Komete -1068
- **Ekstremizmi politik dhe dhunës politike**
Pëlqimet-826; Komete -191
- **Lufta etnike**
Pëlqimet-721; Komete -105
- **Diskriminimi fetar**
Pëlqimet-3157; Komete -553
- **Implikime terroristësh**
Pëlqimet-184; Komete -228

3.1.2 YOUTUBE¹²

Pas Facebook, YouTube është media apo kanali i komunikimit më i përdorur në Shqipëri. Por në faqet shqiptare të YouTube, përveç mediave profesioniste publikojnë video edhe mijëra qytetarë, duke krijuar në këtë mënyre një hapësirë të pasigurt, ku ekziston mundësia për ekspozim ndaj përmbajtjeve me fokus radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Në YouTube u gjetën 24 llogari ku pjesa më e madhe përhapin propagandë fetare. Përdoruesit që përhapin propagandën fetare janë gjithsej 16, nga ku publikimet e tyre pëlqehen rreth 4282 herë dhe përmbajnë rreth 173 komete. Ndjekës të këtyre llogarive janë gjithsej 73.284 abonentë.

Adresat e përdoruesve të tjerë ndahen në:

- 16 adresa me përmbajtje ekstremiste rreth propagandës fetare;

¹² Sipas Shtojcës 4, referencat e gjetura nga Youtube.

- 2 adresa që japin ideologji rreth ekstremizmit politik;
- 2 për luftën etnike;
- 2 për implikime terroristësh;
- 2 për diskriminimin fetar.

Pëlqimet rreth implikime terroristësh dhe luftës etnike ishin gjithsej 182.

Pëlqimet rreth propagandës fetare janë gjithsej 4282. Komete deri më tani 124.



Fig 2: Nr. llogarive në youtube që përhapin propaganda sipas kategorive në grafik

3.1.3 TWITTER, TELEGRAM DHE INSTAGRAM¹³

Në rrjetet sociale Twitter, Telegram dhe Instagram u gjetën 12 adresa përdoruesish, të cilët përhapin më së shumti propagandën fetare.

Respektivisht:

- Në Twitter u gjetën 6 përdorues, nga ku pëlqime ishin gjithsej 50, ndjekës të këtyre adresave ishin 59 abonentë (subscriber).
- Në Telegram u gjetën 4 përdorues, ku ndjekës të këtyre adresave ishin 990 abonentë.
- Në Instagram u gjetën 2 adresa, me 128 ndjekës dhe 54 postime.

¹³ Sipas shtojcës 5, linket e gjetura nga twitter, instagram, telegram




Fig 3: Nr. llogarive në Twitter, Telegram dhe Instagram që përhapin propaganda sipas kategorive në grafik

Bazuar mbi këtë monitorim të rrjeteve sociale është ndërtuar tabela në Figurën 4, e cila ofron informacion mbi numrin e link-eve të gjetura që përhapin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Mbizotëruese janë linket që përhapin ekstremizëm me përmbajtje fetare, por prezentë janë edhe referencat me prirje ekstremizmi politik/ dhuna politike, linke të cilat përmbajnë informacion dhe pikëpamje ekstremiste rreth luftërave etnike, implikime terroristësh në Shqipëri, ekssi dhe diskriminimin fetar.




Fig 4: Numri i link-eve të gjetura që përhapin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm

3.2 FAQET WEB ¹⁴

Analiza e monitorimit dy mujor të faqeve web konfirmon përdorimin e internetit dhe komunikimit online për përhapjen e ideologjive të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, më së shumti në natyrë përshkruese. Nga kërkimi i fjalëve kyçe, u arrit të identifikohen 94 linke (lidhje) me përmbajtje ekstremiste. Këto adresa të ridrejtojnë nëpër rrjetet sociale si Facebook, Youtube dhe Twitter. Nga link-et e kërkuara në faqe interneti, u gjeneruan:

- 56 linke, të cilat përmbanin propagandë fetare;
- 4 linke që përmbanin diskriminimin fetar;
- 8 linke që përmbanin implikime terroristësh;
- 6 linke që përmbanin ekstremizmin me në thelb luftën etnike;
- 12 linke që përmbanin ekstremizmin politik apo dhunën politike.



Fig 5: Nr. linkeve në faqet web që përhapin propaganda sipas kategorive në grafik

3.3 LOJËRAT ONLINE

Për shkak të avancimit të teknologjisë, lojërat online tanimë integrojnë mundësinë që përdoruesit e tyre të flasin më njëri-tjetrit me zë apo video ndërkohë që luajnë, apo për të shkëmbyer informacione personale. Shumica e lojërave si: **Grand Theft Auto: Vice City**, **San Andreas**, **Grand Theft Auto V** dhe lojëra të tjera me vrasje apo skena dhune, mund të përhapin tek fëmijët dhe të rinjtë ekstremizëm të dhunshëm. Përdoruesit e këtyre lojërave përfshihen gjithashtu në situata që ndikojnë në psikologjinë e tyre, si psh. “Vrasin në këmbim të marrjes së parasë dhe kalimit të misioneve”, gjë e cila krijon sjellje agresive, që në moshë të hershme. Përveç përmbajtjes së dhunës, lojërat online mund të përmbajnë urrejtje etnike dhe fetare. Sjellje të cilat demonstrohen nga ata në ambientet e shkollës me fëmijët e tjerë. Sa

¹⁴Sipas shtojcës 2, Referencat e gjetura nga faqet web

i përket rreziqeve sociale, web faqet e lojërave kanë mundësi të integrojnë video mesazhe dhe mundësi komunikimi verbal, gjë që mund të përdoret nga persona dashakeqës për të marrë informacione personale. Këta individë mund të vendosin marrëdhënie shoqërore me fëmijët, hiqen se janë moshatarë të tyre apo ndonjë i rritur, tek i cili mund të kenë besim, e më vonë përpiqen t'i bindin që të takohen drejtpërdrejt.

Referenca të gjetura mbi fjalët kyçe

Gjatë kërkimit të fjalëve kyçe të përgjithshme në motorë kërkimi u gjetën 52 referenca, nga të cilat 30 referenca për fjalët kyçe me risk të lartë ¹⁵




Fig 6: Numri në % i linqeve të gjetura për fjalët kyçe

3.4 GRUPMOSHAT DHE GJINIA E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË KOMUNIKIMIN EKSTREMIST ONLINE




Fig 7: Grupmoshat dhe gjinitë e personave të përfshirë në komunikimin ekstremist online

¹⁵ Referencat përkatëse në shtojcën 2,3,4,5

Gjatë monitorimit të grupmoshave dhe gjinisë së përdoruesve rezultoi se:

- grupmoshat nga 15-25 vjeç meshkuj, të cilët përbëjnë rreth 70% të rasteve të shqyrtuara, janë individët që mund të përhapin më së shumti ekstremizëm të dhunshëm në internet;
- grupmoshat 26-50 vjeç meshkuj përbëjnë rreth 35% të rasteve,
- ndërsa grupmoshat nga 51-80 vjeç përbëjnë rreth 15% të rasteve. Këta janë të përfshirë kryesisht në ekstremizëm politik dhe dhunë politike.
- Femrat rezultojnë të jenë të përfshira më pak në propagandimin e ideologjive ekstremiste të dhunshme, grupmoshat 15-25 vjeç si dhe 26-50 vjeç përbejnë rreth 15% të rasteve.

4. KONKLUZIONE

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit ofrojnë mundësi të shumta për shkëmbimin e njohurive dhe dialogut ndërkulturor. Interneti në veçanti, shërben si katalizator i inovacionit në të gjitha sferat përmes aktorëve të ndryshëm. Ky faktor është më i dukshëm e i rëndësishëm për të rinjtë, si përdoruesit kryesorë në epokën digjiitale. Njëkohësisht, Interneti ka sjellë sfida shqetësuese, si krijimi i komuniteteve virtuale, të cilat mund të çojnë në izolim e marginalizim, dhe në formën e tyre më ekstreme mund të paraqesin kërcënim ndaj çështjeve të sigurisë kombëtare.

Në këtë kuadër, platformat online janë përfaqëuar nga grupe ekstremiste të dhunshme, të cilët gjithmonë e më shpesh po e përdorin teknologjinë për të promovuar dhunën dhe gjuhën e urrejtjes mbi baza etnike, fetare, gjinore e kulturore, për të rekrutuar të rinjtë e për të krijuar komunitete online me shtrirje globale, në të cilat inkurajohen pikëpamjet e sjelljet e dhunshme, duke kontribuar kështu në proceset e radikalizimit.

Monitorimi i përdorimit të këtyre platformave online në një periudhë dy mujore (Nëntor - Dhjetor 2019), dëshmoi se përmbajtja për qëllim të përhapjes së propagandës mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin është aktualisht prezente dhe lehtësisht e arritshme. Analiza e gjetjeve të monitorimit tregoi se pjesa më e madhe e materialeve të gjeneruara nëpër këto motorë kërkimi dhe rrjete sociale nuk ishin shprehimisht të dhunshme, por kryesisht me pikëpamje ideologjike me tendencë radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Disa përfundime kryesore nga monitorimi janë:

- Faqet web dhe mediat sociale në gjuhën shqipe vazhdojnë të luajnë një rol kryesor në përhapjen e ideologjive dhe propagandës së ekstremizmit të dhunshëm. Mbizotëruese janë linket që përhapin ekstremizëm me përmbajtje fetare, por prezentë janë edhe

referencat me prirje ekstremizmi politik/ dhuna politike, linke të cilat përmbajnë informacion dhe pikëpamje ekstremiste rreth luftërave etnike, implikime terroristësh në Shqipëri, ekstremizëm dhe diskriminim fetar.

- Mesazhe ekstremiste dhe gjuha e urrejtjes që nxisin radikalizim nuk janë hequr apo bllokuar nga ofruesit e shërbimit të internetit apo platformat e rrjeteve sociale në gjuhën shqipe edhe pse janë publikuar disa vite më parë.
- Rjeti social Facebook përdoret më së shumti nga përdoruesit që përhapin propagandë ekstremiste në gjuhën shqipe. Përmbajtje ekstremiste ekziston edhe në llogaritë personale dhe të organizatave në Youtube, Twitter, Telegram dhe Instagram. Vëmendje duhet t'i kushtohet dhe lojrave online, të cilat përveç modeleve të dhunës, krijojnë mundësinë për komunikim mes lojtarëve.
- Grupmosha më vulnerabël ndaj mesazheve të ekstremizmit online është ajo 15-25 vjeç, kryesisht të gjinisë meshkuj. Ky segment i shoqërisë, bazuar edhe në studimet e Komisionit Evropian, kanë këtë prirje për arsye të nivelit të lartë të papunësisë, mungesës së arsimimit të nevojshëm, aftësive dhe perspektivave në kontekst të strukturës së familjes, urbanizimit dhe rritjes së perceptimeve mbi marginalizimin. Këta të rinj janë më të rrezikuar edhe për t'u rekrutuar si luftëtarë në zona të konflikteve apo për të kryer akte terroriste në shoqëritë e tyre.

5. REKOMANDIME

Rreziku i shpërndarjes së propagandës ekstremiste dhe radikalizimi online nëpërmjet internetit dhe rrjeteve sociale në gjuhën shqipe vazhdon të jetë i lartë. Si rrjedhojë, është e nevojshme që të zhvillohen më tej rregullime ligjore për të ofruar një hapësirë më të sigurtë në internet nga ekstremizmi online. Qasjet e ndërmarra në vende të tjera në këtë drejtim janë të ndryshme, me disa vende që zbatojnë masa të rrepta rregullatore për ofruesit e shërbimit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë për të bllokuar hyrjen në faqe interneti të caktuara. Ndërkohë, vende të tjera kanë vendosur që të zhvillojnë një qasje rregullatore për sektorin, por duke u mbështetur kryesisht në vetërregullimin nga operatorët e sektorit. Shumica e ISP-ve, platformat web dhe rrjetet sociale, janë detyruar që të përcaktojnë kushte në kontratat e shërbimit, të cilat ndalojnë aksesin në përmbajtje të lidhura me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

U takon politikëbërësve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm për të caktuar qasjen e duhur që mund të sigurojë kundërpërgjigje dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë. Ky studim synon të shërbejë si një nxitës i mëtejshëm për një vendimarrje të duhur dhe të orientuar në interesin e aktorëve të ndryshëm.

Bazuar mbi gjetjet e këtij monitorimi si dhe praktikat më të mira bashkëkohore, mund të ofrohen disa rekomandime për politikëbërësit dhe aktorët e tjerë që përballen më sfidat e ekstremizmit të dhunshëm online:

- Rekomandohet harmonizimi sa më i shpejtë i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë kibernetike, duke krijuar mekanizmin e plotë dhe të qartë të kodifikuar, për të adresuar saktë problematikat që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm online. Është e nevojshme që të krijohen akte ligjore për të rregulluar marrëdhëniet dhe përcaktuar qartësisht detyrat dhe të drejtat e ofruesve të shërbimit të internetit dhe platformave sociale me qëllim bllokimin apo fshirjen e materialeve me përmbajtje ekstremiste të dhunshme.
- Rekomandohet rishikimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit “Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, me qëllim përmirësimin e komponentit të Komunikimit Strategjik dhe krijimin e masave efikase për sigurinë online.
- Ngritja dhe kapacitimi i strukturave institucionale për monitorimin e vazhdueshëm mbi propagandën e ekstremizmit të dhunshëm që qarkullon në platformat online në gjuhën shqipe. Agjencitë ligjzbatuese nevojitet të krijojnë protokolle dhe sisteme të ndarjes së informacionit, për të mbledhur, sistemuar dhe ndarë të dhënat nga një gamë e gjerë burimesh, për të siguruar një kundërpërgjigje parandaluese efektive dhe në kohë në një hapësirë që është kthyer tashmë në “frontin kryesor të luftës” së grupeve terroriste.
- Interneti dhe komunikimet digjitale janë bërë një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të qytetarëve dhe çdo kufizim apo mbikqyrje ndaj personave të dyshuar nuk duhet të keqpërdoret për të shkelur privatësinë e qytetarëve në përgjithësi. Çdo përpjekje për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në internet (si p.sh., rregullimi, filtrimi, apo bllokimi i përmbajtjes online që konsiderohet të jetë e paligjshme në kuadrin e jurisprudencës ndërkombëtare) duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në përputhje me normat e shtetit ligjor, me qëllim që të mos ndikojë në mënyrë të paligjshme mbi lirinë e shprehjes dhe qarkullimin e lirë të informacionit.
- Pavarësisht potencialit që ofron interneti dhe komunikimi online për të përhapur propagandën ekstremiste, duhet të kihet parasysh se ai është vetëm një nga burimet e mundshme të radikalizimit. Studimet e deritanishme dëshmojnë se propaganda ekstremiste online ka patur efekt për persona që ishin të prekur më parë nga probleme sociale, marginalizim apo ideologji ekstremiste. Si rrjedhojë, është e rëndësishme që qasja ndaj rreziqeve të ekstremizmit të jetë sa më holistike dhe të përfshijë të gjithë aktorët dhe grupet e interesit.

Bazuar mbi **Rekomandimin e Komisionit Evropian COM(2017) 555¹⁶** dhe **Direktivën mbi terrorizmën (EU) 2017/541¹⁷**, mund të ofrohen gjithashtu disa masa konkrete që mund të ndërmerren nga autoritetet shqiptare me qëllim reagimin ndaj mesazheve ekstremiste dhe përmbajtjeve të paligjshme të tjera në platformat online :

- Rregullime ligjore për ofruesit e platformave online (faqe interneti, blogje, rrjete sociale etj) për të siguruar pika kontakti apo ndërfaqe teknike, të cilat mund të lejojnë sinjalizimin efektiv dhe në kohë të shpejtë të materialeve ekstremiste të dhunshme nga autoritetet zyrtare apo edhe sinjalizues vullnetarë, me qëllim fshirjen/bllokimin e këtyre materialeve apo profileve. Për këtë qëllim, mund të shfrytëzohet rregullimi ligjor dhe procedurat e ngritura dhe zbatuara së fundi nga Njësia e Referimit e Internetit pranë EUROPOL¹⁸.
- Hartimin e protokollove për ofruesit e shërbimit të internetit në ambjente publike si shkolla, qendra tregtare, bare apo edhe sheshe publike, duke synuar instalimin e filtrave, software të posaçëm apo masa të tjera inovative për të ndaluar aksesimin e përmbajtjeve të dëmshme në internet.
- Ofruesit e platformave online duhet të përcaktojnë në mënyrë të shprehur qartë në kushtet e tyre të shërbimit që ata nuk do të ruajnë materiale me përmbajtje ekstremiste. Kjo ofron një qasje më të pranueshme ndaj ankesave apo masave ligjore që mund të ndërmarrin personat e prekur nga fshirja e materialeve të debatueshme.

¹⁶ Tackling Illegal Content Online – European Commission, 28.9.2017

<https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2017/EN/COM-2017-555-F1-EN-MAIN-PART-1.PDF>

¹⁷ Directive (EU) 2017/541 of the European Parliament and of the Council of 15 March 2017 on combating terrorism

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017L0541>

¹⁸ The EU Internet Referral Unit (EU IRU)

<https://www.europol.europa.eu/about-europol/eu-internet-referral-unit-eu-iru>

SHTOJCA 1, MOTORËT E KËRKIMIT

Motori i parë i kërkimit i përdorur në monitorim shërbeu për të gjeneruar informacion për fjalët kyçe në rrjetin social twitter. Link-et më të shumta të gjetura nëpërmjet këtij motori kërkimi ishin me përmbajtje informuese.

URL Motorit të kërkimit: <https://developer.twitter.com/docs/api/1.1/overview>




Fig: Motori i kërkimit për fjalët kyçe në rrjetin social twitter




Fig: Rezultatet e kërkimit për fjalët kyçe në rrjetin social twitter

Motori i dytë i kërkimit është social-searcher, nga ku gjenerohen analiza dhe statistika rreth fjalës kyçe për të cilën kërkohet. Konkretisht gjeneron përmbajtjen, sa here është përdorur fjala kyçe, tek cila faqe konkrete është përdorur dhe linkun e ridrejtimit tek ajo faqe.

URL Motorit të kërkimit: <https://www.social-searcher.com/social-buzz/?wblngë&ntwë&psttypë&searchidë0&periodë&valueë&fbpageë&q5ëabdullah+azzam+albania>




Fig : Motor kërkimi për të gjeneruar analiza dhe statistika rreth fjalëve kyçe

Një motor kërkimi tjetër është ai Serpstat, nëpërmjet të cilit shfaqet një pamje e shteteve ku ekziston fjala kyçe që po kërkohet, si dhe linqet rreth saj të gjeneruara. Nga studimi rezultoi se pjesa më e madhe e fjalëve kyçe nuk ekzistonin në Shqipëri.

URL Motorit të kërkimit: <https://serpstat.com/>




Fig : Motor kërkimi për të gjeneruar shtetet ku ekziston e publikuar fjala kyçe

SHTOJCA 2, DISA REFERENCA TE GJETURA NGA FAQET WEB

47 lidhje të gjetura nga kërkimi – Kjo shtojcë është mbajtur konfidenciale për aktorët joinstitutionalë për shkak të informacionit sensitiv.

SHTOJCA 3, DISA REFERENCA TE GJETURA NGA FACEBOOK

33 lidhje të gjetura nga kërkimi – Kjo shtojcë është mbajtur konfidenciale për aktorët joinstitucionalë për shkak të informacionit sensitiv.

SHTOJCA 4, DISA LINKE TE GJETURA NGA YOUTUBE.

20 lidhje të gjetura nga kërkimi – Kjo shtojcë është mbajtur konfidenciale për aktorët joinstitucionalë për shkak të informacionit sensitiv.

SHTOJCA 5, DISA LINKE TE GJETURA NGA TWITTER, INSTAGRAM, TELEGRAM

7 lidhje të gjetura nga kërkimi – Kjo shtojcë është mbajtur konfidenciale për aktorët joinstitucionalë për shkak të informacionit sensitiv.

SHTOJCA 6, FJALËT KYÇE PËR MONITORIM

FJALËT KYÇE PËR MONITORIM TE PËRGJITHSHME

Apostasy
Apostate
Apostates
Ayman al-Zawahiri
Caliphate
Crusader
Crusaders
Dabiq
Dabiq Magazine
Ibn Taymiyyah
Islamic State
Jihad
Jihad Meaning
Kafir
Khalifa Meaning
Khilafah
Kuffar
Martyr

Martyrdom in Islam
Martyrs
Mujahideen
Shahada
Suicide Vest

**FJALËT KYÇE PËR
MONITORIM
ME RISK TË LARTË**
Abdullah Azzam
Amaq Agency
Apostate Islam
Apostates in Islam
Beheadings
Crusader Army
Crusaders Against Islam
Dabiq PDF
How to do Jihad
Ibn Taymiyyah Jihad
Inspire Magazine
Jewish Coalition

Jihad for Ummah
Jihad in the Quran
Khalifah
Khilafah Syria
Killing Apostates
Killing Infidels
Killing Kuffar
Mujahid
Preparing for Jihad
Rafidah
Soldiers of the Caliphate
Taghut
Amelije Istishadije
Al-Qaeda
Bidatci
Dawla Islamiyyah
Eksploziv
Emir
Ekstremizëm
Haku
Haëala

Hixhara	Murtedat	ISIL
Ikhuan	Munafik	ISIS
Khalifat	Murxhi	Shtet Islamik (Khalifat)
LHT	Rafidijtë	Shirk
Muxhahid	Shehid	Targut
Muvahid	Sherihat	Tekfir

Akademia e Studimeve Politike

Adresa: Qendra Kotoni, Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, Kati 4, Zyra 2, Tiranë

Tel: +355 04 2272173, email; info@asp.al web: www.asp.al